

RELACION

PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR KORPORATËN E INVESTIMEVE SHQIPËTARE (AIC)”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji “Për krijimin e Korporatës së Investimeve Shqiptare (në anglisht, “Albanian Investment Corporation”), është një iniciative ligjore e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Ky projektligji parashikon krijimin e Korporatës së Investimeve Shqiptare (AIC), e cila vjen si një koncept inovator për të adresuar nevojën e zhvillimit të krijimit të kapaciteteve për lehtësimin dhe realizimin e investimeve komplekse dhe me impakt social-ekonomik.

Korporata krijohet si shoqëri tregtare, e organizuar në formën e një shoqërie aksionare, ku Ministri përgjegjës për ekonominë është në cilësinë e Autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të Korporatës. Institucionet Financiare Ndërkombëtare të Zhvillimit mund të zoterojnë aksione të Korporatës.

Objekti i veprimtarisë së Korporatës është përmirësimi i menaxhimit të pronës publike, krijimi i pronave të reja, vënia në përdorim më eficient të pronave, përgatitja dhe zbatimi i projekteve të investimit, dhe mobilizimi i kapitalit shtetor ose privat, me qëllim kryerjen e investimeve në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit. Objektivi kryesor i aktiviteteve të Korporatës konsiston në krijimin e kushteve të favorshme për të rritur investimet në vend, diversifikimin e prodhimit dhe eksporteve, krijimin e ekspertizës për hartimin dhe zbatimin e projekteve komplekse të investimit, si dhe paisjen e shtetit Shqiptar me një kapacitet të munguar për realizimin e investimeve.

Efektet e funksionimit të Korporatës do të ndihen në krijimin dhe forcimin e hallkave ekonomike rreth projekteve të investimit që do të kryejë Korporata, rritjen e punësimit, transformimin e zonave ku do të bëhen investimet e Korporatës, lehtësimin për tërheqjen e investitoreve, dhe shtimin e marrëdhënieve midis sektorit publik dhe privat.

Fusha e veprimtarisë dhe mjetet që i duhen Korporatës për të kryer funksionet e parashikuara kërkojnë përgatitjen e kuadrit ligjor specifik dhe ky projektligj do të pasohet me disa vendime të Këshillit të Ministrave për të bërë të mundur zbatimin e ligjit dhe rregullimin e plotë të veprimtarisë së Korporatës, në funksion të efektivitetit në përmbushjen e funksioneve dhe misionit të saj, pajtueshmerine me sistemin ligjor dhe bashkëpunimin me institucione të tjera publike ose ndërkombëtare.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj nuk është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për vitin 2019.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Qeveria e Shqipërisë ka nevojë të shpejtojë procesin e rritjes ekonomike duke zgjeruar kapacitetin e ekonomisë për të identifikuar, përgatitur dhe ekzekutuar projekte investimi me impakt të gjerë. Këto lloj projektsh kërkojnë shfrytëzimin e asetëve shtetërore, si dhe mobilizimin e kapitalit privat. Shumë nga këto projekte nuk mund të realizohen nga sektori privat pa përfshirjen në një masë të konsiderueshme të shtetit në procesin e dhënies së autorizimit dhe në vënien në dispozicion të asetëve. Kjo ndërhyrje nga sektori publik në fazën përgatitore dhe të para-investimit është e nevojshme pasi të dy këto hapa rezultojnë të jenë të kushtueshme financiarisht po t'ju lihen në dorë sektorit privat. Shumë vende, në të gjithë fazat e zhvillimit, krijojnë shoqëri zhvillimi që të konceptualizojnë projekte, dhe sigurojnë kombinimin e duhur të asetëve shtetërore me investimet private për të arritur qëllimin e rritjes ekonomike.

Për të zbatuar me efektivitet këtë qëllim, është e domosdoshme për të patur një kuadër të fortë institucional dhe qeverisës të procesit. Përvojat e shumta ndërkombëtare kanë treguar se sigurimi i një kuadri të tillë është faktori kryesor i suksesit dhe shpesh herë është siguruar nëpërmjet krijimit të një institucioni të posaçëm.

Qeveria shqiptare ka nevojë për një institucion që të ndërmarrë role të ndryshme lidhur me zhvillimin ekonomik, role këto që aktualisht nuk ushtrohen nga ndonjë institucion tjetër. Një institucion i tillë ka nevojën për të patur kapacitetin të transformojë ide dhe inisiativa investimesh në projekte të financueshme dhe tërheqjen e interesit nga investitore cilësore. Shumë projekte kërkojnë që qeveria të përdore më mirë tokën ose asetet e tjera në pronësinë e saj, përgatisë projekte që nëse vlerësohen të përshtatshme, mund të financohen. Për të mobilizuar kapitalin, institucioni në fjalë duhet të ketë kapacitetin për të strukturuar transaksione dhe të japë mbështetje financiare kur duhet për të reduktuar riskun tregëtar.

Projektligji është hartuar në bashkëpunim e ekspertet e Universitetit të Harvardit, me Qendrën për Zhvillim Ndërkombëtar (CID).

Rolet dhe funksionet e Korporates

Pas një analize të institucioneve të zhvillimit të sektorit publik dhe potencialit të investimeve në vend, propozojmë krijimin e një korporate investimi, “Korporata e Investimeve Shqiptare (Albanian Investment Corporation)”. Kjo strukturë nuk ekziston aktualisht në ekosistemin e agjensive në vend dhe as në sektorin privat. Është një njësi, me thelbin e një fondi investimesh, por me qëllim të përcaktuar për zhvillimin ekonomik të vendit.

Njësi që po propozojmë është e konceptuar për të qenë në gjendje të përfaqesojë Qeverinë Shqiptare në menaxhimin e aseteve strategjike dhe në maksimizimin e mobilizimit të kapitalit privat. Ajo është e konceptuar të marrë përsipër shfaqjen e riskut në projektet strategjike dhe gjithashtu të bashkëpunojë me institucione financiare ndërkombetare (IFIs) dhe sektorin privat.

Disa nga funksionet kryesore konsistojnë në:

- Analiza e projekteve (transformimi i “ideve” në “projekte të financueshme”);
- Strukturimi financiar i projekteve;
- Vënien në përdorim më eficient të pronave shtetërore;
- Mobilizimi i kapitalit privat (marrja e rreziqeve të kalkuluara).

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Përgatitja e projektligjit është bazuar në nenet 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës së Shqipërisë dhe ligji nr. 9901/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk synon përafrimin me *acquis communautaire*.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji është i ndarë në 6 kapituj dhe 25 nene.

Në **nenin 1** është përcaktuar se projektligji ka si qëllim krijimin e Korporatës së Investimeve Shqiptare dhe rregullon organizimin, funksionimin dhe veprimtarinë e saj.

Në **nenin 2** të projektligjit përcaktohen objektivat e korporates të cilat janë:

- a. Nxitja e zhvillimit ekonomik dhe social nepërmjet projekteve të investimit në nivel qendror, vendor dhe rajonal, në mbështetje të politikave shtetërore të zhvillimit;
- b. Vënien në përdorim më eficient të pronave shtetërore;
- c. Kryerja e investimve duke mobilizuar kapital shtetëror dhe/ose privat;

Në nenin 3 përcaktohen parimet e përgjithshme me anën e të cilave udhëhiqet Korporata, të cilat janë:

- a. përparësia e zhvillimit ekonomik dhe social në nivel qendror, vendor dhe rajonal, si dhe lidhjen me politikat shtetërore të zhvillimit;
- b. pavarësia në vendimmarrje, në kryerjen e funksioneve dhe në propozimin e projekteve;
- c. trajtimi në mënyrë të drejtë dhe të barabartë i palëve me të cilat bashkëpunon;
- d. zbatimi me efektivitet, efikasitet, dhe ekonomicitet i funksioneve dhe detyrave;
- e. nevojshmërinë dhe proporcionalitetin në marrjen e masave për realizimin e objektivave;
- f. respektimi i parimit të konkurrencës së lirë dhe efektive, në procedura dhe treg;
- g. zbatimi i procedurave transparente, të thjeshta dhe të kontrollueshme;
- h. integriteti dhe ndalimi i konfliktit të interesave në kryerjen e funksioneve dhe marrëdhëniet me partnerët dhe palët e treta;
- i. përgjegjësisë ndaj palëve të interesuara dhe partnerëve;
- j. përgjegjësisë për zhvillimin e politikave sociale.

Përveç parimeve të përcaktuara me sipër, Korporata udhëhiqet edhe nga parime e kritere të tjera, të përcaktuara statut dhe në aktet e tjera të saj, si dhe në marrëveshjet respektive me institucionet dhe/ose palët e treta.

Në nenin 4 është përcaktuar statusi i Korporatës, e cila krijohet si shoqëri tregtare, në përputhje me legjislacionin për tregtarët dhe shoqëritë tregëtare, e organizuar në formën e një shoqërie aksionere. Ministri përgjegjës për ekonominë përcaktohet si autoriteti publik, që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të Korporatës. Institucionet Financiare Ndërkombëtare të Zhvillimit mund të zoterojnë aksione të Korporatës. Procedura, kriteret dhe formula e pjesmarrjes së Institucioneve Financiare Ndërkombëtare të Zhvillimit përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në nenin 5 përcaktohen burimet financiare të korporatës. Fillimisht me krijimin e saj Korporata do të financohet nga buxheti i Shtetit, i cili do të shërbej si kapital fillestar i Korporatës. Gjithashtu, Korporata mund të financohet edhe nga:

- a. kontributi i buxhetit të shtetit me Vendim të Këshillit të Ministrave, kontributi i institucioneve publike dhe/ose i institucioneve financiare ndërkombëtare;
- b. transferimi i pronave publike për zhvillimin dhe realizimin e projekteve të Korporatës;

- c. fondet dhe/ose kontributet materiale të investitorëve për zhvillimin dhe realizimin e projekteve;
- d. donacionet ose dhuratat;
- e. të ardhurat e përfituara nga aktivitetet e saj dhe shërbimet e ofruara;
- f. burime të tjera, të lejuara nga legjislacioni në fuqi, dhe aktet e saj të brendshme.

Në këtë nen përcaktohet se Korporata gëzon të drejtën e marrjes së kredive nga institucione financiare dhe sanksionohet se detyrimet financiare të Korporatës nuk i transferohen buxhetit të shtetit, pra përgjegjësia për shlyerjen e detyrimeve financiare është detyrim i Korporatës.

Në nenin 6 përcaktohen funksionet e Korporatës, të cilat janë sipas rastit, hartimi, analizimi, koordinimi, menaxhimi, përfaqësimi, financimi, zbatimi, dhe mbikëqyrja e projekteve të investimit. Gjithashtu kjo dispozitë përcakton dhe funksionet kryesore të Korporatës, të cilat janë:

- a. zhvillimi dhe menaxhimi i pronave shtetërore;
- b. hartimi i projekteve të investimit në pronat shtetërore dhe sipas rastit, merrja përsipër e zbatimit të tyre;
- c. analizimi dhe shqyrtimi i projekteve të investimit të paraqitura nga institucione vendase ose të huaja, publike ose private;
- d. financimi apo bashkëfinancimi i projekteve të investimeve në pronat shtetërore dhe/ose private;
- e. Hyrja në marrëdhënie bashkëpunimi me institucione financiare vendase dhe/ose ndërkombëtare për të siguruar investime;
- f. Vepromi si pronar i pronave të fituara nga Korporata ose pronave shtetërore të transferuara tek ajo;
- g. vepromi si palë kontraktuese me palë të treta.

Në nenin 7 përcaktohen menyrat e transferimit të pronësive shtetërore tek Korporata.

Ne këtë nen është përcaktuar se kur Korporata identifikon pronat shtetërore me interes për të realizuar projekte investimi, i propozon Këshillit të Ministrave, nëpërmjet ministrit përgjegjës për ekonominë, transferimin e tyre tek Korporata.

Me vendim të Këshillit të Ministrave, Korporatës mund t'i kalojë:

- a) E drejta e pronësisë së pronave shtetërore;
- b) E drejta e përdorimit të pronave shtetërore.

dhe se kriteret dhe procedurat për dhënien e pronës, e cila ka kaluar tek Korporata me qira, enfitëozë, leasing, përdorimit, transferimit, shitjes, përdorimit si kolateral, ose të përdorimit në formë të tjera, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave

Ne nenin 8 janë përcaktuar rastet e dhenies së autorizimeve.

Kështu është përcaktuar se me propozim të ministrit përgjegjës për ekonominë, Këshilli i Ministrave me vendim mund të autorizojë Korporatën:

- c) Të kontraktojë, ndërmjetësojë ose zbatojë projekte;
- d) Të funksionojë si autoritet kontraktues bashkëpjesëmarrës në projektet e investimeve strategjike, sipas legjislacionit për investimet strategjike;
- e) Të marrë rolin e zhvilluesit/operuesit në Zonat Teknologjike dhe Zhvillimit Ekonomik, sipas legjislacionit në fuqi;
- f) Të ushrojë funksione të tjera, të deleguara nga Këshilli i Ministrave.

Ne **nenin 9** janë përcaktuar format e pjesëmarrjes së korporatës në investime si më poshtë:

- a. Korporata vepron si investues i vetëm në projekt investimi;
- b. Korporata vepron si bashkëzhvilluese e investimit;
- c. Korporata vepron si bashkëzhvilluese e një zone territoriale të caktuar, në të cilën realizohen investime;
- d. Korporata vepron si bashkëpjesëmarrëse në investim, në forma të tjera.

Gjithahshtu është përcaktuar se procedurat dhe format e pjesëmarrjes së korporatës në investime përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në **nenin 10 deri në 12** përcaktohen masat mbështetëse të Shtetit në mbështetje të Korporatës me infrastrukture ndihmëse, për marrjen e licencave dhe përjashtimin nga prokurimi publik.

Kështu për zhvillimin dhe zbatimin e një projekti investimi, Korporata mund të mbështetet nga Shteti me infrastrukture ndihmëse, të tilla si: rrugë, ujësjellës, kanalizime, energji elektrike dhe telekomunikacion.

Ministria përgjegjëse për ekonominë, në bashkëpunim me ministritë e tjera, shqyrton dhe verifikon nevojat dhe kërkesat për infrastrukturë ndihmëse, si dhe vlerëson koston e përafërt për realizimin e saj, kosto kjo e cila nuk duhet të jetë disproporcionalisht e lartë, në raport me vlerën dhe rëndësinë e projektit të investimit.

Mbështetja me infrastrukturë ndihmëse miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të Ministrisë përgjegjëse për ekonominë.

Eshtë përcaktuar se kur autorizohet nga Këshilli i Ministrave për realizimin e një projekti, Korporata përgatit dokumentacionin e nevojshëm për finalizimin dhe ekzekutimin e projektit. Korporata dorëzon për miratim në organet kompetente dokumentacionin e nevojshëm që kërkohet nga legjislacioni sektorial për miratimin e licencave/lejeve/autorizimeve së bashku me mandatpagesat e tarifave respektive dhe se organet kompetente nëse konstatojnë që dokumentacioni është i paplotësuar, i kërkojnë Korporatës plotësimin e të gjithë dokumentacionit dhe të dhënat e kërkuara duke listuar kërkesat në mënyrë specifike.

Institucionet/entet/autoritetet publike, me marrjen e dokumentacionit nga Korporata, brenda 15 ditëve pune, kthejnë përgjigje mbi kërkesën për miratim të licencave/lejeve/autorizimeve, sipas legjislacionit në fuqi. Përjashtimisht nga sa parashikohet më lart, për shkaqe të

arsyeshme që lidhen me kompleksitetin e licencave/lejeve/autorizimeve, afati shtyhet vetëm një herë, për një periudhë kohore prej 30 ditë pune.

Nëse organet kompetente nuk njoftojnë vendimin e arsyetuar në lidhje me kërkesën për marrjen e licensave/lejeve/autorizimeve brenda periudhës prej 30 ditë pune, të kësaj dispozite, ato konsiderohen të miratuara në heshtje.

Gjithashtu është përcaktuar se Korporata përjashtohet nga rregullat e prokurimit publik. Procedurat dhe rregullat e prokurimit të veçantë sipas kësaj pike, përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me praktikën më të mirë të Institucioneve Financiare Ndërkombëtare të Zhvillimit.

Në **nenin 13** përcaktohen organet drejtuese të Korporatës, të cilat janë: Asambleja e Përgjithshme, Këshilli Mbikëqyrës, Drejtori Ekzekutiv dhe Bordi Këshillimor.

Neni 14 përcakton se Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Korporatës si dhe çështjet për të cilat vendimmarrja është prerogativë e Asamblesë së Përgjithshme. Asambleja merr vendime për çështjet e mëposhtme:

- a) Miratimin e statutit të Korporatës;
- b) Miratimin e strategjisë;
- c) Miratimin e projekteve të investimit, kur kërkohet transferimi i pronave shtetërore;
- d) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë së Korporatës;

Çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ky ligj, ligji për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, si dhe statuti i Korporatës.

Neni 15 flet për përbërjen e Këshillit Mbikëqyrës. Këshilli përbëhet nga pesë anëtarë nga të cilët: tre anëtarë janë përfaqësues të institucioneve qendrore dhe dy përfaqësues janë njeri nga biznesi dhe tjetri nga fusha akademike. Përcaktohet se mandati i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës është 3 vjet, ndërsa kriteret, emërimi dhe lirimi i tyre do të përcaktohen në Statutin e Korporatës.

Kompetencat e Këshillit përcaktohen në **nenin 16** të projektaktit dhe dispozita përcakton se Këshilli Mbikëqyrës, i cili gjatë ushtrimit të funksionit të tij ka këto detyra:

- a. Propozon për miratim pranë Asamblesë statutin e Korporatës, dhe ndryshimet në të;
- b. Propozon për miratim pranë Asamblesë strategjinë e Korporatës;
- c. Miraton planin e biznesit dhe planet vjetore të punës;
- d. Miraton dhe më pas propozon pranë Asamblesë, projektet e investimit, kur kërkohet transferimi i pronave shtetërore;
- e. Miraton ngritjen e strukturave të tjera të Korporatës;

- f. Kontrollon dhe mbikëqyr zbatimin e politikave dhe projekteve të investimit të Korporatës;
- g. Miraton treguesit e performancës dhe monitoron performancën e saj;
- h. Kujdeset që Korporata të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit;
- i. Siguron që pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, kryhen me saktësi nga Korporata;
- j. Siguron që auditimi i librave dhe i regjistrimeve kontabël kryhet të paktën një herë në vit nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur;
- k. Zhvillon, zbaton, monitoron, dhe komunikon kontrollet e brendshme, programet për përputhshmërinë ligjore, etike, si dhe masa të tjera, përfshirë edhe ato që kontribuojnë në parandalimin e mashtrimit dhe korrupsionit.
- l. Emëron dhe liron Drejtorin Ekzekutiv;
- m. Përcakton pagat dhe shpërblimin e administratës së Korporatës, përfshirë edhe anëtarët e Bordit Këshillimor.

Këshilli Mbikëqyrës bashkëpunon me Bordin Këshillimor në marrjen e vendimeve.

Këshilli Mbikëqyrës miraton ngritjen e komiteteve të specializuara për përmbushjen e detyrave të tij.

Këshilli Mbikëqyrës miraton procedurat dhe kriteret për shqyrtimin dhe miratimin e projekteve.

Këshilli Mbikëqyrës, përmbush edhe detyra të tjera të parashikuara nga ky ligj, ligji për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, si dhe statuti i Korporatës.

Në nenin 17 përcaktohet se Drejtori Ekzekutiv është përfaqësuesi ligjor i Korporatës dhe përgjigjet përpara Këshillit Mbikëqyrës. Kjo dispozitë autorizon Këshillin Mbikëqyrës për emërimin dhe shkarkimin e Drejtorit Ekzekutiv sipas kushteve, afateve dhe rregullave të cilat do të përcaktohen në aktet e brendshme të Korporatës dhe në kontratën me Drejtorin Ekzekutiv. Në këtë dispozitë parashikohet se Drejtori i parë Ekzekutiv rekrutohet nëpërmjet një konkursi të organizuar nga një komitet i specializuar, i krijuar nga nga Këshilli Mbikëqyrës, në përbërjen e të cilit do të jenë ekspertë të jashtëm. Përcaktohet se Komiteti i pranimit duket të marrë në konsideratë dhe opinionin e Bordit Këshillimor, gjatë rekrutimit të Drejtorit Ekzekutiv, i cili duhet të plotësojë këto kritere:

- a. të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre ose kundravajtje penale;
- b. të zotërojë të paktën master shkencor ose me lart, në fushën e ekonomisë, financave, biznesit, drejtësisë, ose fusha të ngjashme;
- c. të ketë të paktën 7 vite pune në nivel të manaxherit të lartë në sektorin publik ose privat, në fushat e tregjeve financiare ndërkombëtare, investimeve bankare, të drejtës, infrastrukturës dhe qeverisjes së korporatave.

Në nenin 18 përcaktohen kompetencat e Drejtorit Ekzekutiv, i cili gjatë ushtrimit të funksionit të tij, ka detyrë:

- a. të administrojë veprimtarinë e Korporatës;
- b. të përfaqësojë Korporatën në marrëdhënie me të tretët;
- c. të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të Korporatës;
- d. të përgatisë dhe të nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, të cilët ia paraqesin Këshillit Mbikëqyrës për miratim, së bashku me propozimet për investimin e fitimeve;
- e. të krijojë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat që kërcënojnë menaxhimin, performancën dhe ekzistencën e Korporatës;
- f. të kryejë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të Korporatës, sipas parashikimeve të këtij ligji apo të ligjeve të tjera;
- g. të raportojë përpara Këshillit Mbikëqyrës dhe Bordit Këshillimor për zbatimin e politikave dhe projekteve të investimit të Korporatës;
- h. të sigurojë zbatimin e vendimeve të Këshillit Mbikëqyrës, legjislacionit, dhe akteve të brendshme të Korporatës;
- i. të bashkëpunojë me Bordin Këshillimor për të propozuar projekte investimi për miratim në Këshillin Mbikëqyrës;
- j. detyra të tjera të ngarkuara nga kuadri ligjor dhe nënligjor, statuti dhe akte të tjera të brendshme të Korporatës.

Neni 19 përcakton përbërjen dhe kompetencat e Bordit Këshillimor, i cili përbëhet nga 9 (nëntë) anëtarë që zgjidhen nga Këshilli Mbikëqyrës. Katër prej tyre përfaqësojnë institucionet qendrore, tre institucionet ndërkombëtare financiare të zhvillimit dhe dy të tjerë janë të pavarur, nga të cilët njëri është përfaqësues i biznesit dhe tjetri nga fusha akademike. Neni 14 i atribuon Këshillit Mbikëqyrës edhe kompetencën e miratimit të kritereve dhe procedurës së zgjedhjes në Bordin Këshillimor.

Bordi Këshillimor sipas këtij neni ka funksion këshillues për Këshillin Mbikëqyrës dhe Drejtorin Ekzekutiv, mbi iniciativat, projektet e propozuara për Korporatën dhe aktivitetet e tjera të saj. Bordi informon rregullisht Këshillin Mbikëqyrës dhe Drejtorin Ekzekutiv mbi zhvillimin dhe zbatimin e planit të punës së Korporatës dhe mund të ngrejë komitete të specializuara për të kryer detyrat e tij, përfshirë edhe një komitet për të këshilluar mbi shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës.

Në nenin 20 përcaktohet se struktura dhe organika e Korporatës miratohen nga Këshilli Mbikëqyrës dhe se marrëdhëniet e punës së personelit të Korporatës do të rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë dhe akteve të brendshme të Korporatës.

Në nenin 21 dhe 22 përcaktohet se Korporata duhet të mbajë kontabilitetin e veprimtarisë së saj ekonomike, në përputhje me ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat

financiare”, si dhe të përgatitë raportin e veprimtarisë, inventarët dhe llogaritë vjetore, në përputhje me legjislacionin kontabël në fuqi. Gjithashtu, përgatit auditimin e pasqyrave financiare të Korporatës sipas legjislacionit në fuqi për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar.

Nenet 23, 24 dhe 25 flasin për dispozitat kalimtare dhe hyrjen në fuqi të aktit ligjor.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj krijon efekte financiare pasi krijon strukturë të re shtetërore.

Për vitin 2019, nga Buxheti i Shtetit është parashikuar një fond buxhetor prej 368 Milion Lekë, në buxhetin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si kapital fillestar për Korporatën.

MINISTËR

Arben Ahmetaj